



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1062/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada Glllogjani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Dardan Krasniqi nga Subjekti Politik Demokratët për Drenasin, me seli në Drenas, dega në Komunën e Drenasit, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1062/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Dardan Krasniqi, nga Subjekti Politik Demokratët për Drenasin, në Komunën e Drenasit, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimet me nr.0301E, 0301X, 0302E, 0305E, 0313E, 0320E, 0324E, 0304E, 0311E.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1062/2021 të paraqitur nga Dardan Krasniqi, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Demokratët për Drenasin, me të cilën kërkon rinumërimin e pothuajse të gjitha vendvotimeve në Komunën e Drenasit, me konkretisht në vendvotimet me nr. 0301E, 0301X, 0302E, 0305E, 0313E, 0320E, 0324E, 0304E, 0311E, pas publikimit të rezultateve nga KQZ-ja, pretendon se ka mos përputhje të rezultatit ngase sipas rezultatit të shpallur nga KQZ-ja figurojnë 211 vota, dhe se ky rezultat është i pa pranueshëm nga se ka pritur një numër më të madh te votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Dardan Krasniqi, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Demokratët për Drenasin, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimet 0301E, 0301X, 0302E, 0305E, 0313E, 0320E, 0324E, 0304E, 0311E, dhe votave me kusht është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tije, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme, për faktin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi, formular apo ndonjë deklaratë që do të dëshmonte se pretendimet e tije për pa rregullsi në vendvotimet përkatëse janë të bazuara.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.1062/2021 më datën 05.11.2021

Kryesues i Panelit
Erki Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.